REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR.12

Datë 09.09.2026 ora 13 : 00 ºº

Zhvillohet mbledhja e posaçme e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës "Njoftim", të kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.3560. Prot datë 04.09.2026, me rend dite si më poshtë :

1-Miratim i rendit të ditës.
2- Miratim i procesverbalit Nr.10, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 01.08.2026.
3- Miratim i procesverbalit Nr.11, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.08.2026.
4- Miratim i projekt - vendimit, "Për shprehjen e mosdakordësisë së Këshillit Bashkiak Rrogozhinë me propozimin për bashkimin e Bashkisë Rrogozhinë me Bashkinë Kavajë në kuadër të riorganizimit administrativo-territorial".
5- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%".
6- Miratim i projekt - vendimit, "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2026 nga fondi i pushtetit vendor".
7- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Erind Tosku, Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gezime Met-hasani, Altin Tosku, Lorena Baku, Mitat Daja, Saimir Cani, Dhurata Meka, Indrit Dedej, Silvana Aliu , Hekuran Xhani, Mukades Gixhari

Mungojnë :

Besnike Coraj, Sokol Gosa ,Lije Dedej, Merilin Saraçi,

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Të ftuar :

1. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
4. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
6. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
10. Artur Kaja - Përgjegjës i sektorit të pyjeve.
11. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
12. Megi Toska- Drejtore e Kadastrës
13. Sara Demrozi- Nënprefekte e qarkut Tiranë

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak: Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 17-Këshilltarë të pranishëm.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari. Përshëndetje të nderuar këshilltarë meqë e kemi korumën e nevojshëm, mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur.
Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët: Erind Tosku, Renato Kalemi, Fatmira Tartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Lulzim Hasa, Gëzim Met-hasani, Lorena Baku, Sajmir Cani, Dhurata Meka, Indrit Dedej, Silvana Aliu, Hekuran Xhani dhe Mukades Gixhari.
Gjithashtu kam kënaqësinë t'ju bëj me dije se sot kemi të pranishme në mbledhje zonjën Sara Demrozi, nënprefekte e qarkut Tiranë. për bashkitë Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë. I urojmë mirëseardhjen dhe e përshëndesim përzemërsisht nënprefekten duke uruar shumë suksese në detyrën e saj të re dhe një bashkëpunim sa më të frutshëm në vijim në shërbim të qytetarëve dhe

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

komunitetit. Tjetër ju informoj që mbledhja e fundit e Këshillit Bashkiak që u zhvillua me datë 26.08.2026 në këtë mbledhje nuk pati vendime të miratuara nga ana e Këshillit Bashkiak. Kjo është një mbledhje e posaçme në të cilën do trajtojmë një çështje me rëndësi shumë të madhe për të ardhmen e bashkisë Rogozhinë, të cilën e kemi në rendin e ditës, pika nr.4.
T'i marrim me radhë dhe para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, do të gjeni përpara të fotokopjuar secili një projekt vendim shtesë, miratim i projektvendimit për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin shtator 2026 nga fondi i pushtetit vendor. Jeni dakort ta përfshijmë në rend dite këtë projektvendim dhe ta shqyrtojmë në vijim të mbledhjes?
E hedhi në votim. Pro, kundra, abstenim, të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 14 (katërmbëdhjetë) vota pro, përfshirja në rendin e ditës të projekt-vendimit "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2026 nga fondi i pushtetit vendor".

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Është miratimi i rendit të ditës.

Mukades Gixhari. Po, zoti Indrit.

Indrit Dedej. Ne nënprefektes i urojmë punë të mbarë por do të ishte më serioze që ne të kishim dijeni që nënprefekja që do ishte prezente sot sepse ne e kemi kërkuar shumë herë prefekturës të jetë këty dhe nuk kanë ardhur asnjëherë .

Mukades Gixhari. Po e vërtetë e kemi bërë kërkesën.

Indrit Dedej. Të paktën nga ju unë e prita që të na jepni një konformim lehtë se ndoshta nuk e kemi ditur…

Mukades Gixhari. Jo nuk e ka ditur.

Indrit Dedej. Edhe kështu që edhe ajo s'mund të vijë pa na e bërë me dije sepse ne jemi këshill bashkiak dhe nuk jemi këtu punonjës e prefektës .Në qoftë se ju nuk e keni ditur se prefektja s'mund të vijë pa ftesë ose pa një lajmërim që thotë lajmëroj këshillin bashkia…

Sara Demrozi. Atëhere unë kam bërë kërkesë..

Indrit Dedej. Më fal nuk e kisha me ju e kisha me kryetaren…

Sara Demrozi. Unë kam bërë kërkesë kryetarit të bashkisë që të jem e pranishme në këshillim dhe mbledhje të këshillit bashkiak. Kam ardhur sot me miratim nga zoti Andi Proshka dhe sa për dijeninë tuaj unë kam ardhur në rolin si nënprefekte si palë dëgjues dhe asnjë gjë tjetër .

Indrit Dedej. Jo, jo nuk kam kundërshtim thash ishte e këndshme që të kishim dijeni që presim nënprefekten.. Kryetarja e këshillit thotë ne nuk ishim në dijeni që do të vinit..

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Mukades Gixhari. Kush tha, kur e thashë!

Indrit Dedej. Po ishit në dijeni që do të vinte nënprefekja?

Mukades Gixhari. Po si jo , e ka bërë kërkesë zyrtare nënprefekja.

Silvana Aliu. Te këshilli mund të ishte shkruaj 2-3 orë para që do jetë e pranishme dhe nënprefekja.

Mukades Gixhari. Zoti Indrit, nuk kemi pikë në rend të ditës për të njoftuar pjesmarrjen..

Indrit Dedej. Zonja kryetare nuk e kemi presim pjesëmarrje, tani unë po them që ti je detyuar që të njoftosh për çdo gjë se ne jemi këshillim bashkiak kemi kaq kohë që kërkojmë nga prefektura dhe nuk na vijnë.

Mukades Gixhari. Mbledhjet janë të hapura zoti Indrit dhe mund të marri pjesë kushdo.

Andi Proshka. Nuk keni pse e ktheni në diskutim…

Indrit Dedej. Kryetari në detyrë ajo është nënprefekte nuk është qytetare e thjeshtë, a kishit të drejtë ju që të na lajmëronit sepse jemi këshilltarë.

Silvana Aliu. Një lajmërim te grupi nuk do të ishte keq, të nderuar këshilltarë do të të jetë e pranishme edhe…

Erind Tosku. Më fal që po ndërhy Indrit, ka ardhur me dëshirën e saj për të qenë në këshill bashkiak, të jam mendimin tim aq më mirë që ka ardhur ankesat që ke që kemi të gjithë ne si këshill bashkiak dhe ankesat për prefekturën mund ti mbaj shënim dhe mund ta delegojë aq më mirë që ka ardhur. Po patjetër pse jo, nuk thua shyqyr që ka dëshirë dhe ka ardhur…

Indrit Dedej. Dakort.

Erind Tosku. Unë kështu mendoj thashë…

Indrit Dedej . Po pra kryetarja , kryetari duhet të thotë që po nuk ju njoftuam por nënprefekja nuk është qytetare nuk është drejtoreshë drejtorie që na erdhi s'na erdhi drejtoreshë, e kemi kërkuar 10 herë drejtoreshës dhe sot na ka ardhur drejtoresha a kupton?

Erind Tosku. Jam shumë dakort, unë e shoh si një gjë pozitive që ka ardhur dëshirën e vet.

Silvana Aliu. Duhej të ishte bërë njoftim në grup.

Indrit Dedej. Duhet të ishim njoftuar I urojmë shumë suksese në detyrën e re.

Mukades Gixhari. Faleminderit zoti Indrit.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën dy. Miratimi i procesverbalit numër 10 i mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 01.08.2026 e hedhim në votim?

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

Erind Tosku. Rendin e ditës, nuk e ke kaluar.

Mukades Gixhari. Pra, miratimi i rendit të ditës e hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 14 (katërmbëdhjetë) vota pro, pika e parë (1) e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën dy. Miratimi i procesverbalit në nr. 10 të mbledhjes së këshillit bashkiak datë 01.08.2026. E hedhim në votim pro, kundra abstenim të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 14 (katërmbëdhjetë) vota pro, pika e dytë (2) e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tre. Miratimi i procesverbalit nr. 11 të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 26.08.2026. E hedhim në votim pro, kundra, abstenim. Të gjithë pro miratohet.

(Mbledhjes i shtohet dhe këshilltari zoti Mitat Daja min 7:57).

(Mbledhjes i shtohet dhe këshilltari zoti Altin Tosku min 7:57).

-Miratohet me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota pro, pika e tretë (3) e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën katër. Po ju bëj një parashtrim ku sipas kërkesave të cituara në shkresa përcjellëse të projektligjit për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë janë plotësuar dërgjesat publike të cilat u zhvilluan në njësitë administrative dhe në qytet. Është plotësuar mendimi zyrtar i kryetarit të bashkisë si dhe mungon mendimi zyrtar i këshillit bashkiak, çështje të cilën ne do ta shqyrtojmë tani. Të tre këto dokumenta përbëjnë dosjen e cila do t'i përcillet Kuvendit të Shqipërisë. Pra jeni i njohur me projektvendimin, me qëndrimin e zyrtar të kryetarit. Mbetet dhe vendimi i Këshillit Bashkiak. Ka ndonjë koment të nderuar këshilltar?

Zoti Indrit Dedej, fjala për ju.

Indrit Dedej. Unë them meqë jemi te pika për reformë terrritoriale dhe meqë kemi dhe prefekten këtu mund ta që kemi informacion pse bashkia Rrogozhinës përfshihet në shkrirjen dhe bashkimin me Kavajën, domethënë a keni informacion ju nga qeveria që për çfarë arsye ikën bashkia nga qyteti në Kavajë?

Sara Demrozi. Jam dëgjuese të thash edhe më parë, nuk marr dot pjesë në debatet e lejuara, në rregull. Këto janë vendime të kuvendit, nuk janë vendime as të prefekturës apo të kujdo tjetër. Pra këto miratohen nga kuvendi ligjërisht.

Indrit Dedej. Po pjesë e qeverisë je dhe ti …

Sara Demrozi. Çdo njeri ka kompetencat e veta.

Indrit Dedej . Meqënëse ju jeni institucioni më i lartë e kisha detyrim të jua bëja këtë pyetje.këtë

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

pyetje.

Sara Demrozi. Jo, patjetër edhe unë kam përgjegjësitë e mia..

Mukades Gixhari. Mbledhjes iu bashkua zoti Shpati Kolgega.

(Mbledhjes iu bashkua zoti Shpati Kolgega min 10:14).

Mukades Gixhari. Zoti Mitat Daja kishte diçka për të thënë?

Mitat Daja. Unë kisha një pyetje për kryetarin e bashkisë në fakt sepse ai duhet të sqarojë i pari nga pozicioni se cila është arsyeja që bashkia e Rrogozhinë do shkrihet, pra ka ndonjë arsye specifike mosrealizim të ardhurash, mosfunksionim bashkie, ku di unë…numri popullsisë pra cilat janë arsyet që ato e kanë paraqitur aty që mos s'më duken shumë…

Andi Proshka. Atëherë unë kam përgatitur dhe një material. Përshëndetje të gjithëve. E nderuar kryetare, të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak, e nderuar nënprefekte te uroj suksese në detyrën e marrë. Atëherë edhe ne si institucion dhe mendimi i kryetarit të bashkisë për propozim nga grupi i deputetëve propozues të mazhorancës parlamentare anëtarë të komisionit dhe posaçëm parlamentar për reformën administrative territoriale 2.0. Në kuadër të proçesit të reformës administrative territoriale 2.0 të ndërmarrë nga komisioni i posaçëm parlamentar, bashkia Rrogozhinë paraqet qëndrimin e saj institucional lidhur me propozimin për ndryshimin e statusit dhe kufijve territorial të bashkisë Rrogozhinë. Konkretisht propozimin me bashkimin me bashkinë Kavajë. Institucioni i bashkisë Rrogozhinë dhe këshilli bashkiak sapo është vënë në dijeni zyrtarisht të këtij propozimi bazuar në ligjin 139.2015 për vetëqeverisjen vendore të ndryshuar organizuan informimin dhe konsultimin e popullatës në çdo njësi administrative me anë të dëgjesave publike bazuar dhe në shkresën 3271 me datë 11.08.2026. Gjatë këtyre takimeve qytetarët kanë pasur mundësinë të njihen me argumentet dhe shpjegimet e paraqitura nga komisioni dhe të shprehen qëndrimin e tyre. Nga dëgjesat dhe konsultimi me komunitetin rezulton një qëndrim i qartë. Qytetarët që kanë marrë pjesë nuk janë dakort në bashkimin e bashkisë Rrogozhinë me bashkinë Kavajë. Ky qëndrim është shprehur edhe pas marrjes së informacionit dhe shpjegimeve lidhura me propozimin c'ka tregon se kundërshtimi i komunitetit nuk lidhet me mungesën e informacionit, por me një vlerësim të vetë qytetarëve mbi identitetin, nevojat dhe interesat e territorit ku ato jetojnë. Vullneti i shprehur qartë nga qytetarët e Rrogozhinës nuk qëndron i vetëm por mbështetet nga një sërë faktesh, treguesish dhe rezultatesh konkrete që dëshmojnë se bashkia Rrogozhinë përbën një njësi territoriale me identitet, funksionalitet dhe potencial të veçantë zhvillimin. Në këtë kuadër bashkia Rrogozhinë paraqet për shqyrtim të komisionit të gjitha të dhënat dhe argumentet që lidhen me performancën institucionale, administrimin e territorit,gjendjen financiare, investimet e realizuara, zhvillimin ekonomik, potencialin bujqësore dhe turistik, infrastrukturën, ofrimin dhe shërbimet publike dhe perspektivën e zhvillimit të territorit tonë. Këto fakte nuk synojnë vetëm të kundërshtojnë një propozim administrativ, por të dëshmojnë në mënyrë objektive se vullneti i qytetarëve për ruajtjen e bashkisë

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Rrogozhinë si si një njësi më vete përputhet me realitetin dhe interesin e zhvillimit të territorit. Për këtë arsye qëndrimi i komunitetit dhe argumentet e institucionit duhet të vlerësohen së bashku. Qytetarët shprehin vullnetin, ndërsa të dhënat dhe rezultatet konkrete dëshmojnë se ky vullnet mbështetet mbi një realitet të matshëm territorial, ekonomik dhe institucional. Bashkia Rrogozhinë i paraqet këto fakte me bindjen se vendimmarrja për të ardhmen administrative të territorit duhet të bazohet jo vetëm në një propozim për ndryshim kufijsh, por në një vlerësim të plotë të vullnetit qytetar, funksionalitetit të njësisë vendore, rezultateve të arritura dhe potencialit të zhvillimit të saj. Elementet mbi të cilët bashkia Rrogozhinë mbështetet në kundërshtimin e saj janë ruajtja e identitetit dhe funksionaliteti i njësive aktuale territoriale. Bashkia Rogozhinë është themeluar si bashki në vitin 1992. Prej atij viti ka funksionuar si bashki më vete e përbërë vetëm nga qyteti i Rrogozhinës. Reforma territoriale e vitit 2014-2015 e ndryshoi në mënyrë thelbësore strukturën territoriale të bashkisë. Nga një qytezë me sipërfaqe 10 km² bashkia Rrogozhinë u shndërrua në një vendore me sipërfaqe 223.5 km² e përbërë nga qyteti i Rrogozhinës, 36 fshatra dhe pesë njësi administrative janë Rrogozhinë, Lekaj, Kryevidh, Gosë dhe Sinaballaj. Kjo strukturë nuk përbën thjesht një ndarje administrative, por ka krijuar një territor funksional me karakteristika të qarta ekonomike, bujqësore, turistike, infrastrukturore dhe sociale. Në territorin e bashkisë Rrogozhinë ndodhen rreth 7 km vijë bregdetare përfshirë zonën e Vilë Bashtovës, Grethit dhe të Spillesë ndërkohë që lumi Shkumbim përshkon territorin dhe derdhet në zonën e Vilë Bashtovës, territori përfshin gjithashtu zonat pyjore, bujqësore për zhvillim, nëntë rezervuar ujor dhe qindra kilometra kanale kulluese vaditëse me rëndësi për zhvillim dhe në funksion të banorëve të zonës. Gjithashtu, përfshirja e fshatrave të Vilë Bashtovës dhe Gërmenjit në programin kombëtar të 100 fshatrat është një dëshmi e qartë e potencialit të jashtëzakonshëm që mbart bashkia Rrogozhinë. Këtu ndërthuren bujqësia dhe agroturizmi, historia dhe trashëgimia kulturore, natyra dhe duke krijuar një identitet të veçantë dhe mundësi reale për aspektin kulturor kalaja e Bashtovës konsiderohet pasuri e veçantë si e vetmja kala fushore në të gjithë territorin e Ballkanit Perëndimor. Në aspektin historik, rruga Egnatia , një nga rrugët më të rëndësishme të periudhës romake, përshkon territorin e bashkisë Rrogozhinë, duke ju dhënë zonës një vlerë të veçantë historike dhe kulturore. Ky aks lidhte brigjet e detit Adriatikut me lindjen dhe shpërblente për lëvizjen, tregëtinë.

Mitat Daja. Unë kisha një shtesë një shtesë tjetër.

Andi Proshka. Ja ta mbaroj ta mbaroj pak edhe këtë..

Mitat Daja. Po se këtë e dëgjuam njëherë tek dëgjesa..

Andi Proshka. Rrogozhina lidhet historikisht me Asparagun një stacion i rëndësishëm përgjatëkëtij itenerari, pozicioni pranë luginës së Shkumbin shkon rolin e hershëm të zonës si nyje strategjike komunikimit. Nga rruga përbën një pasuri të veçantë të trashëgimisë së Rrogozhinës me potencial për promovimin dhe zhvillimin e turizmit historik e kulturor. Sot në

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

këtë emër historik e përmban me krenari në futboll edhe Egnatia skuadra që ka çuar emrin e Rrogozhinës përtej kufijve të Shqipërisë.

Indrit Dedej. Duam të përse arritë në këtë, pse po flasim për qytetin tonë…

Andi Proshka. Ta mbaroj unë mendimin tim, pak respekt ju lutem.

Silvana Aliu. Ne duam ta dimë pse po bashkohemi?Coje ta lexojnë ato lart jo ne, ne e dimë. E dimë Rrogozhinën e dimë cfarë kemi bërë por falë jush…

Mukades Gixhari. Raporti që ka përgatitur kryetari i bashkisë..

Silvana Aliu. E kemi dëgjuar.

Erind Tosku. Se kanë dëgjuar qytetarët ckeni nuk duroni dot, po ta dëgjojnë…

Andi Proshka. Shiko nëse ju nuk e keni mundimin me dëgju të paktën 10 minuta…

Erind Tosku. Jo, jo gjynah ju që sleni me dëgjuar po…

Indrit Dedej. Sa fjalësh ke…

Andi Proshka. Kur ta mbaroj do jenë edhe dhëna të tjera, kur ta mbaroj..

Mitat Daja. Po ta dëgjojmë deri në fund pastaj secili do flasi. Ai po argumenton qëndrimin.

Mukades Gixhari. Kryetari po thotë ato që themi ne.

Alime Hoxha. Jo të gjithë ndoshta e kanë ndjek meqënëse mbledhja është online ta dëgjojmë deri në fund..

Silvana Aliu. Pikërisht pse'kishte populli interes nuk ju erdhi në kinema.

Andi Proshka. Të gjitha këto që po lexohen apo janë fakte edhe të gjitha këto janë gjëra që pse duhet të qëndrojë Rrogozhina.

Silvana Aliu. E dimë por po flasim për bashkinë, çka bërë bashkia që ka shkuar në këtë gjendje..

Indrit Dedej. Po flasim për bashkinë sepse kryetari i bashkisë është i zgjedhur nga populli jo i emëruar nga...

Andi Proshka. Do rrimë tek rendi i ditës… kemi tjetër diskutim .

Mukades Gixhari. Zoti Mitat I kërkuat kryetarit.

Mitat Daja. Po pra po dua ta dëgjoj të mbaroj dhe kam edhe pyetje të tjera. Do të më rezervosh dhe kohën për të bërë pyetje të tjera pas mbarimit të kryetari pastaj të vazhdojnë edhe të tjerët.

Mukades Gixhari. Pyetje kanë të gjithë për të bërë kështu me radhë.

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

Mitat Daja. Sigurisht.

Andi Proshka. Atëherë sot këtë emër historik e përmban me krenari futboll klub Egnatia skuadra që e ka çuar në Rrogozhinën për të Shqipërisë.

Silvana Aliu. Falë Agim Demrozit.

Andi Proshka. Patjetër.

Andi Proshka. Ju lutem se nuk shkon me ndërprerë disa herë fjalën.

Silvana Aliu. Ne për këtë jemi këtu.

Andi Proshka. Je këtu edhe për të dëgjuar nuk je vetëm për të ndërprerë fjalën.

Indrit Proshka. Çfarë ke arritur ti që bashkia Rrogozhinës të shkojë në Kavajë?

Andi Proshka. I ke aty cfarë kam arritur.

Indrit Dedej. Nuk ke asgjë aty.

Mukades Gixhari. I ke te pika e tretë, lexoje pikën e tretë dhe janë aty të përmbledhura.

Andi Proshka. Interpretimi dhe realiteti i të dhënave demografike. Sipas sensit të popullsisë dhe banesave në 2023 bashkia Rrogozinë ka 12507, ndërsa të dhënat në regjistrin e gjendjes civile numri i regjistruar është mbi 42.000 banorë. Me këto të thëna dy burime metodologji të ndryshme dhe nuk duhet të paraqiten …

Mukades Gixhari. Zoti Indrit të lutem tek hera e parë dhe fundit që ndërpret.

Andi Proshka. Kërkojmë që komisioni të sqarojë secili tregues të përdoret për secilin kriter.

Indrit Dedej. Opozita zë ka..

Andi Proshka. Dhe të marrë në konsideratë edhe ngarkesën administrative që lidhet me popullsinë e regjistruar. Krahas popullsisë rezidente të madhe nga censusi kjo diferencë nuk duhet të përdoret mekanikisht si argument për dobësinë e njësisë vendore. Përkundrazi, ajo tregon një nga problematikat strukturore që karakterizojnë territorin shqiptar, migrimin dhe lëvizjen e popullsisë. Me propozimin e ri Rrogozhina do të përbënte rreth 29.5% të popullsisë së njësisë së konsoliduar. Ndërsa Kavaja rreth 70.5% .Rrogozhina do të ruhear si qytet përbërës po pa buxhet dhe pa personalitet juridik të veçantë. Për këtë arsye duhet analizuar jo vetëm ekzistenca formale e përfaqësimit, por ndikimi real i territorit të Rrogozhinës në vendimmarrjen buxhetore për caktimin e prioriteteve dhe shpërndarjen e investimeve. Për rrjedhojë vlerësimi i funksionalitetit të një bashkie nuk duhet të mbështetet vetëm me një tregues numerik të popullsisë, por në një analizë të kombinuar të territorit të ekonomisë, shërbimeve, të ardhurave, infrastrukturës, kapaciteteve administrative dhe perspektivës së zhvillimit. Llogaritja e distancave për marrjen e shërbimeve

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

për qytetarët. Sipas ligjit 139 2015 për vetëqeverisjen vendore e lidh misionin e vetëqeverisjes vendore me qeverisjen efektive dhe efikase në nivel sa më afër qytetarëve. Njohjen e vlerave të ndryshme të bashkive dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me nevojat e tyre. Bashkia Rrogozhinë në pesë njësi administrative dhe me një territor të gjerë rural ka krijuar tashmë një sistem të organizuar të administrimit territorial. Kështu që një bashkim i ri do të krijonte njësi territoriale edhe më të madhe dhe do të kërkonte riorganizim të strukturarve administrative, shërbimeve, planifikimit territorial, buxheteve dhe prioriteteve të investimit. Në materialin e reformës paraqitet distanca Rrogozhinë- Kavajë prej 17.9 km dhe një kohë udhëtimi prej 22.8 minuta. Këto të dhëna matin vetëm lidhje ndërmjet dy qendrave. Ato nuk matin aksin real të qytetarëve në të gjithë territorin e bashkisë Rrogozhinë. Bashkia Rrogozhinë ka sipërfaqe rreth 223.5 km² dhe pesë njësi administrative. Për të vlerësuar afërsinë me qytetarin duhet të maten distancat dhe koha e udhëtimit nga të gjitha këto njësi dhe nga zona bregdetare dhe nga fshatrat periferike deri në qendrën e propozuar në Kavajë. Po ashtu pohimi se qytetarët e Rrogozhinës marrin shërbime në Kavajë duhet të mbështetet me të dhënat të matshme të cilat sa shërbime do t'i ofron qytetari dhe çfarë frekuence të cilat realisht i mungojnë aty atyre. Prandaj përpara çdo ndryshimi duhet të provohet në mënyrë konkrete se çfarë përfitimi shtesë do të marri qytetari i Rrogozhinës nga ky bashkim. Përtej atyre shërbimeve që aktualisht mund të ofrohen ose të përmirësohen përmes plotësimit të kapaciteteve të bashkisë. Në mungesë të një analize të tillë kosto përfitim, shkrirja e njësie funksionale nuk mund të konsiderohet automatikisht si rritje e efiçencës. Kapacitetet administrative dhe institucionale. Një nga rezultatet konkrete të reformës së vitit 2015 ka qenë zgjerimi i kapaciteteve administrative të bashkisë Rrogozhinë. Nga 40 punonjës në janar të vitit 2015 administratës i bashkohet 162 punonjës në tetor të vitit 2015, ndërsa në dhjetor të vitit 2025 struktura e bashkisë përbëhej nga 345 punonjës deri tani. Në të njëjtën periudhë u konsoliduan edhe shërbimet publike dhe institucionale në territor edhe institucionet e tjera shtetërore që nuk janë pjesë e aparatit vendor siç janë Ujësjellës Rrogozhinë, OSHE, sigurime shoqërore, qendra shëndetësore, posta shqiptare, policia shtetit. Treguesit financiar vendor dhe kapacitet që kanë. Një prej argumenteve kryesore që duhet të merret në konsideratë çdo rishikim territorial dhe afërsia e njësisë për t'u gjeneruar dhe administruar burimet financiare. Të dhënat e bashkisë tregojnë një përmirësim të konsiderueshëm të performancës financiare. Realizimi i të ardhurave vendore shfaq një tendencë të përgjithshme në rritje gjatë periudhës 2016-2025 ku shënohet me rritje afërsisht 135% brenda një periudhe 10 vjeçare. Buxheti total për të gjithë bashkinë në krahasim me vitin 2026 ka rritje me 585%. Buxheti nga vetë vendor në vitin 2025 në krahasim me vitin 2016 ka rritje me 292.5%. I shpërndarë në zëra kryesorë kryesisht paga, sigurime etj. Realizimi i planit është përmirësuar nga 44% në 2016 . në 65% në vitin 2025. Borxhi publik në vitin 2020 shënon rritje me 174.8% në krahasim me vitin 2018 dhe në periudhën 2020-2024 borxhi ulet në 60.5%. Në periudhën 2016-2020 numri i bizneseve erdhi në rënie për të ardhurat vijuan të rriteshin. Kjo tregon sa ndikim ka pasur përmirësimi i administrimit fiskal, rritja e nivelit të arkimit dhe zgjerimi i bazës së të ardhurave për subjektet ekzistuese. Në fund të vitit 2020-2025 rritja e numrit të bizneseve ka kontribuar më tej rritjen e të ardhurave duke reflektuar një zhvillim

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

pozitiv ekonomik dhe fiskal në territorin e bashkisë. Këto të dhëna nuk dëshmojnë për njësi vendore të paaftë financiarisht por një bashki që ka kaluar një proçes real konsolidimi që ka përmirësuar ndjeshëm performancën e saj fiskale. Për këtë arsye mungesa e kapacitetit financiar nuk mund të konsiderohet argumenti i mjaftueshëm për shkrirjen e bashkisë Rrogozhinë. Më poshtë nuk po lexoj, janë disa investime më kryesore që janë bërë gjatë periudhës 2016 deri në 2025. Rëndësia strategjike e Rrogozhinës për projektet e ardhmes. Në një perspektivë afat të mesme dhe afatgjatë Rrogozhina pret një rol edhe më strategjik. Në dekadën e ardhshme pritet që ajo të shndërrohet në një nyjë kyce infrastrukturore dhe ekonomike pasi në këtë territor kalojnë do të zhvillohen projekte të rëndësishme kombëtare si korridori tetë , aksi Kashar Lekaj, hekurudha Durrës-Rrogozhinë, Rrogozhinë-Pogradec, Rrogozhinë -Vlorë. Këto investime e pozicionojnë bashkinë tonë si një qendër lidhëse të rëndësishme mes jugut dhe veriut. Analiza, faktet dhe kërkesat të bashkisë Rrogozhinë. Vlerësojmë se analiza statistikore duhet të bëjë një dallim të qartë ndërmjet një treguesi dhe një kriteri të përfunduar për ndryshimin e organizimit territorial në indekset IPB, IPE dhe IM. Janë të dobishme për të evidentuar fusha ku kërkohet ndërhyrje, por nuk duhet të përdoren të shkëputura nga njëra-tjetra dhe as të zëvendësojnë analizën e territorit, shërbimeve apo financave. Fakti, vetë fakti që Rrogozhina paraqet IP-në 46.3% në nivel të mesëm, ndërkohë që IPB-ja është i ulët tregon se profili i bashkisë është i përzierë dhe kërkon zbërthimin e shkaqeve konkrete. Kjo në një përfundim të vetëm të nxjerr nga indekësi i pafavorshëm. Për këtë arsye kërkojmë që për Ifb-në e cila është e ulur në 8.3 të na vihet në dispozicion llogaritja e plotë e pesë komponenteve. Viti referues i së cilës është dhënë burimi administrativ, mënyra e normalizimit dhe pesha që secili komponent ka për realizimin përfundimtar. Vetëm në këtë mënyrë mund të kuptohet nëse rezultati lidhet me një dobësi strukturore afatgjatë apo me faktorë të një periudhe të caktuar që tashmë janë në përmirësim e sipër. Për sa më sipër kërkojmë që statistikat e paraqitura për bashkinë Rrogozhinë të mos interpretohen në mënyrë të izoluar dhe që përfundimi për konsolidim të rishikohet mbi bazën e të dhënave të përditësuara të tregut financiar, aksit real të qytetarëve, funksionalitetit institucional, potencial ekonomik dhe territorial. Në të njëjtën dosje Rrogozhina paraqet me 834 ndërmarrje aktive dhe 2072 të punësuar në ndërmarrje, ndërsa Kavaja me 1.790 ndërmarrje dhe 8153 të punësuar. Edhe këto të dhëna duhet të interpretohen në raport me popullsinë, strukturën ekonomike dhe territorin. Për Rrogozhinën , bujqësia dhe aktivitetet familjare rurale nuk pasqyrohen gjithmonë në të njëjtën mënyrë si aktiviteti urban i formalizuar. Mos po zgjaten , mos duhet të shkoj në përfundim.

Silvana Aliu. Raportin e kemi e kemi lexuar.

Andi Proshka. Rëndësi të veçantë ka edhe raporti ndërmjet sipërfaqes së popullsisë. Rogozhina administron 223.5 km². Pra, një sipërfaqe më të madhe se 198.8 km kore që është ajo e Kavajës. Pas konsolidimit nëse do t'i krijohen një bashki midis Rrogozhinës dhe Kavajë do të kishin 422.3 km². Rritja e sipërfaqes së administruar mund të sjellë ekonomi në shkallë në disa funksione, por mund të rrisë njëkohësisht postat e lëvizjes për çdo qytetar, kontrollin e territorit, mirëmbajtjen e rrjetit rrugor, shërbimeve në zonën rurale dhe aksesin e qytetarëve. Për këtë arsye kërkohet një

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

analizë kosto përfitim për të dyja palët. Nëse argumenti është qendra e re në Kavajë, kjo do të kërkohë një administratë më të specializuar. Duhet të përcaktohet se cilat kapacitete mungojnë sot në Rrogozhinë dhe sa do të kushtonte forcimi i tyre në krahasim me kostot institucionale dhe sociale të konsolidimit. Një reformë proporcionale duhet të shqyrtohet fillimisht nëse objektivi mund të arrihet me masa më pak ndërhyrëse, për shembull përmes asistencës teknike, dixhitalizimit, shërbimeve të përbashkëta ndërmarrjeve ndërbashkiake. Po kështu ruajtja e Rrogozhinës si qytet përbërës nuk është me ruajtjen e bashkisë së Rrogozhinë sipas strukturës së propozuar. Qyteti përbërës nuk do të ketë buxhet të vetin dhe personalitet juridik për secilën bashki. Në këto kushte ne kërkojmë që vlerësimi demografik të shoqërohet me analizën e strukturës së popullsisë dhe jo vetëm me numrin total. Pra, një territor me sipërfaqje të gjëra, zona rurale dhe bregdetare rëndësi kanë shpërndarja e popullsisë dhe sezoni i tyre. Lëvizje ditore, popullsia e regjistruar që kërkon shërbime administrative dhe zhvillimet e përditshme ekonomike. Censusi 2023 është burim zyrtar themelor për popullsinë rezidente, por ai nuk e përjashton përdorimin transparent të regjistrave administrativ për të kuptuar ngarkesën e shërbimeve dhe lidhjen e qytetarëve me territorin. Bashkia Rrogozhinë kërkon që komisioni posacëm parlamentar të mos e bashkimin në bashkinë Kavajë si një zgjidhje të nevojshme apo të justifikuar nga të dhënat objektive të territorit. Përkundrazi në mbështetje të argumenteve dhe fakt të paraqitjeve në këtë parashtrim kërkojmë që Rrogozhina të ruhet si bashki me vete në respekt të funksionalitetit të saj, potencialit dhe zhvillimit të vullnetit të komunitetit që ajo përfaqëson. Ky qëndrim nuk buron nga një kundërshtim formal ndaj riorganizimit territorial. Ai mbështetet me një realitet konkret dhe të verifikueshëm. Rrogozhina është një territor funksional me identitet të konsoliduar dhe kapacitete institucionale dhe potenciale të rëndësishme ekonomike, bujqësore, turistike e infrastrukturore në një perspektivë zhvillimi që përfaqësohet përmes investimeve publike. Për rrjedhojë nuk prezanton një nevojë objektive që shkrirja e saj të paraqitet si kusht për përmirësimin e qeverisjes apo zhvillimin e territorit. Në këtë vlerësim, merr një pjesë të veçantë vullneti i komunitetit. Bashkia ka përmbushur proçesin e dëgjesave publike. Qytetarët janë informuar dhe kanë dëgjuar argumentet e paraqitura lidhur me këtë propozim. Megjithatë pas këtij procçesi qëndrimi i tyre ka qenë i qartë. Qytetarët pjesëmarrjes nuk e mbështesin bashkimin e Rrogozhinës me bashkinë Kavajë. Ky vullnet nuk mund të reduktohet në një element formal të konsultimit. Ajo është një shprehje e drejtpërdrejtë e komunitetit për një vendim që prek identitetin , përfaqësimin, administrimin dhe të ardhmen e territorit të tij. Ndërsa qytetarët dëgjohen, informohen dhe pas informimit shprehin qartë kundërshtimin e tyre, atëherë ky qëndrim duhet të hyjë në thelb të vendimmarrjes. Në të njëjtën kohë faktet e paraqitura nga bashkia i japin këtij vullneti një bazë objektive. A thotë se kërkesa për ruajtjen e Rrogozhinës nuk mbështetet vetëm në ndjenjën përkatëse të komunitetit, por edhe në funksionalitetin institucional, rezultatet e administrimit, potenciale të territorit dhe mundësinë reale për të vijuar zhvillimin si një njësi vendore më vete. Bashkia Rrogozhinë beson në një reformë territoriale të drejtë. Nuk matet vetëm me numrin e njësive, administrative që krijohen apo shkrihen, por me atësinë e saj për të ndërtuar qeverinë si sa më të mirë, përfaqësim më të drejtë, shërbime më të afërta dhe zhvillim më të qëndrueshëm për

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

qytetarët. Në këto objektiva mund të arrihen duke ruajtur Rrogozhinën si bashki në vete. Shkrirja e saj nuk mund të konsiderohet një domosdoshmëri. Rrogozhina nuk kërkon privilegj, kërkon që vendimmarrja për të ardhmen e saj të ndërtohet mbi atë që realisht është më e mirë për qytetarët e saj. Nuk kërkon të mbetet bashki vetëm për hirë të shkuarës, por sepse ka një territor që funksionon, një komunitet që shprehet një të ardhme zhvillimi që meriton të mbështetet. Prandaj bashkia Rrogozhinë i kërkon komisionit të posaçëm parlamentar që në vlerësimin e tij të marrë në konsideratë në mënyrë të plotë vullnetin e shprehur këtë komunitetit pa këtë objektiv. të territorit, funksionalitet institucion të potencialit të zhvillimit të bashkisë Rrogozhinë dhe të mos e përfshijë atë në një proces bashkimi me bashkinë Kavajë. Faleminderit.

Mukades Gixhari. Faleminderit.

Mitat Daja. Mund ta bëj një pyetje?

Mukades Gixhari. Zonja Silvana

Mitat Daja. Mund ta bëj unë meqënëse kisha logjikën .

Mukades Gixhari. Zoti Mitat duhet të bësh një pyetje.

Mukades Gixhari. Po zonja Silvana fjala për ju.

Silvana Aliu. Atëherë në radhë të parë kryetar populli nuk ju mbështeti fare, aty ku kishit dhe dëgjesat publike kishit vetëm punonjësit e bashkisë këtë fiksojeni në tru, ta keni qartë që nuk ju mbështeti dhe së dyti ndoshta ai popull që po ju ndjek është budalla si puna ime na thoni shkoqur ta dimë pse po bashkohem nuk kam nevojë për ato unë letra..Shkoqu dy tre të paktën me aq sa di unë tek KLSH-ja kan gjet shkelje tani shërbimet i keni për tokë… Ju thoni shërbimet, shërbimet i ke për tokë, pastrimi I qytetit është për tokë nuk është larë njëherë gjatë muajv të verës..

Andi Proshka. Nuk është e vërtetë.

Silvana Aliu. Unë sikur jetoj Okshtun e nuk jetoj këtu. E dyta. sa për ato që jemi debitorë e kemi ditur sepse e kemi dëgjuar gjithmonë, sa për numrin e punëtorëve ke gabim se është numri më i madh 200 i keni në shtëpi rrinë në shtëpi dhe marin rrogën kot dhe na thuaj bukur e pastër ta dëgjoj dhe populli se është si puna ime pse po bashkohemi nuk kam nevojë të tregosh historinë e bashkisë së Rrogozhinës çfarë është dhe krahasimet me Kavajën , nëqoftëse Kavaja qenka më keq se në të vijë ajo të bashkohet me Rrogozhinën.

Andi Proshka. Më fal unë nuk jam anëtar i komisionit të posacëm .

Silvana Aliu. Diku është bazuar.

Andi Proshka. Siç ju ka ardhur ju zyrtarisht shkresa nga komisioni më ka ardhur dhe mua.

Silvana Aliu. Diku është bazuar thotë performanca shumë e dobët e bashkisë.

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

Andi Proshka. Zonja Silvana tani ke një pyetje apo ke 30? Për sa i përket dëgjesave publike qytetarët janë informuar gati tre javë përpara, vendi, ora data si nga bashkia si nga këshilli bashkiak. Ju e nderuar anëtare këshillit duhet në ato vota që keni marrë qytetarët që keni në krah duhet të vini nga…

Silvana Aliu. Qytetarët e mi svijnë se sjanë krahu juaj po të vinin qytetarët tuaj.

Andi Proshka. Më fal ti kë përfaqëson kë?

Silvana Aliu. PD.

Andi Proshka. Jo përfaqëson qytetarët.

Silvana Aliu. Po, pra PD.

Andi Proshka. Mbledhje kanë qenë të hapura. Nuk mund të thuash që kanë qenë punonjësit e bashkisë që këtu e ke gabim. Ka qenë salla e pallatit të kulturës, ka qenë e hapur janë njoftuar.

Silvana Aliu. Po e di unë .

Andi Proshka. Kanë qenë të hapur, ka qenë ftuar edhe media dhe merrte pjesë kushdo. Ok. Çfarë përgjigje doje tjetër?

Silvana Aliu. Po pra pse po bashkohen?

Andi Proshka. Po pra, nuk jam anëtar i komisionit të posacëm. Këtu janë shkresa që ka sjellë komisioni dhe unë i kam kthyer përgjigjet për secilën pikë që ato kanë thënë. Nuk e vendos unë shkrirjen apo bashkimin e bashkinë Kavajë. Unë mbështes qytetarët. Çfarë thonë qytetarët unë mbështes ato.

Mukades Gixhari. Pyetje tjetër.

Mitat Daja. Kam unë pyetje.

Mukades Gixhari. Po, zoti Mitat.

Mitat Daja. Po kam dy pyetje në fakt.

Mukades Gixhari. Të lutem vazhdon me një që t'i japim radhë të gjithëve.

Mitat Daja. Ndjekin njëra tjetrën në pyetjet e mia, prandaj e kam kështu mirë. njëra pas tjetrës. Atëherë pyetja numër një,po e drejtoj pyetjen e sinqertë se normalisht ky lloj projekt vendimi e ka bërë mazhoranca dhe pjesa e këtyre janë përfaqësues të mazhorancës. Ore ju keni dëshirë pyetja që është shumë e sinqertë të bashkoheni apo keni dëshirë të rrini me Rrogozhinën e para .

Erind Tosku. Pyetje ne që morëm të parët vendim që s'jemi dakord bashkohemi .

Mitat Daja. Po ckeni?

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

Erind Tosku. Po e bën gabim pra, se ne morëm vendim kundër që në fillim kundër , ti mazhoranca je po apo jo?

Mitat Daja. Përgjigju gabimin tim, përgjigju gabimin tim .

Erind Tosku. E ka gabim .

Silvana Aliu. Spo kuptojmë qëndrimin tuaj ne ndaj.

Mitat Daja. Përgjigju pyetjes time…

Erind Tosku. Këtë sta lejoj unë ty.

Mitat Daja. Dëgjo, dëgjo këto formalitetet …

Erind Tosku. Kemi qenë nga të parët bashki…

Mitat Daja. Një sekond je ti ..

Erind Tosku. Një sekond mos bëj provokime, një sekondë këtë s'ta lejoj.

Mitat Daja. Po mirë unë do provokoj, atë punë kam më vjen keq. Kam pyetjen numër dy mirë s'ka gjë pyetje numër një ti japi përgjigje publiku.

Mukades Gixhari. Zoti Mitat, më dëgjo të lutem!

Mitat Daja. Pyetja numër dy , një pjesë e këshilltarëve këtu të Rrogozhinës që jemi këtu te pjesa e mazhorancës, na sollën njëherë një emër për ta bërë qytetarin nderi aq herë e sollën se na bën me turp se mos pranosh të marrësh një vendim për të bërë qytetar nderin

Mukades Gixhari. Mos kalo jashtë rendit të ditës.

Mitat Daja. Jo, kjo është brenda e rendit të ditës. Pse këto këshilltarët e nderuar sot nuk mblidhen dhe ti drejton copë letër atij. I nderuar Mitat Daja ne deshëm të bëjmë qytetar nderit ty këtu sot në Rrogozhinë tani dëshmoje që ti e do Rrogozhinë se ne do të bëjmë prapë qytetarë nderi se nuk të kemi berë deri tani..

Mukades Gixhari. Zoti Mitat!

Mitat Daja. E kupton s'du të përmend tani sepse ndoshta s'është etike.

Erind Tosku. Përmende Mitat se e nise muhabetin.

Mitat Daja. Po mirë jepni përgjigje, po mirë kjo provokim është? A je ti është reforma juaj, nuk është reforma jonë.

Lulzim Hasa. Clidhje ka qytetari i nderit tani me reformën territoriale.

Mitat Daja. Sigurisht , jemi kundra bashkimit, ju që e keni në dorë se ne vetëm fjalën kemi ne

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

nuk na pyet njeri. Votën e kam kundër bashkimit por ne nuk na pyet njeri.

Mukades Gixhari. Ju lutem

Silvana Aliu. Ti kthej pak përgjigje Mitatit

Mitat Daja. Tani do ndjekim logjikën apo do ndjekim formalin përgjigje pak.

Silvana Aliu. Mitat, për personin që po flet letrat janë bërë gati dhe do bëhet qytetar nderi. Kështu që mos e kthe në debat.

Mukades Gixhari. Nuk e kemi në rendin e ditës më vjen keq që dilni jashtë rendit të ditës.

Mitat Daja. Ne kërkuam që presidenti i republikës bëhet qytetar në nderi sepse është nga zona jonë, e kërkuam dhe sot bëjmë një letër, po jo more po jap një mendim. Bëjmë një letër i nderuar president i republikës je nga Rrogozhina nga zona jonë, na ndihmo që të qëndrojmë.

Mukades Gixhari. Zoti Mitat Daja.

Silvana Aliu. Presidenti i republikës lobon.

Mitat Daja. Jam gabim këtu, jam gabim Fatmira?

Mukades Gixhari. Zoti Mitat mund ta vazhdojmë mbledhjen aty ku e lamë? Zoti Mitat Daja për pyetje numër dy, kryetari sapo e lexoj raportin duke dhënë argumenta për pikat e forta të bashkisë tonë pse ne nuk duhet të bashkohemi me Kavajën i ka shkruar të gjithë një dy tre katër ju tani pas këtij raporti bën prapë pyetjen pse?

Mitat Daja. Ne kemi bërë një kërkesë zysh ,ne do ta votojmë sot atë atë mosbashkimin.

Mukades Gixhari. Lëri rradhë kolegut të flasi.

Mitat Daja. Kemi bërë një kërkesë për të paraqit bashkë me ne këtu një nga anëtarët e komisionit, ju e keni dërguar dikujt kërkesën tonë ju. Tani do të bëjmë formalitet do bëjmë kështu sikur nuk duam. Unë ndaj pyeta doni apo nuk doni nëse nuk doni le të bashkohemi me Kavajën.

Mukades Gixhari. Nga raporti që u lexua.

Mitat Daja. Urdhëro.

Mukades Gixhari. Nga raporti që sapo u lexua cfarë kuptove jemi kundra apo pro bashkimit?

Mitat Daja. Ku është një përfaqësues i komisionit këtu që të na dëgjojmë ne?

Mukades Gixhari. Jeni kundra apo pro bashkimit?

Mitat Daja. Po sigurisht që jemi kundra bashkimit.

Mukades Gixhari. Po atëherë…

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

Mitat Daja. Ku është drejtuesi i komisionit komisioni që na që ka vendosur për ne?Po ku është pra tani doni apo s'doni? Ky është problemi.

Mukades Gixhari. Të dëgjojmë pak zotin Enver Memolla.

Mitat Daja. Po sa lidhje ka do votosh këtë? Sepse e dinë që nuk do votosh ndryshe. Po ideja është që kush ta ka miratuar këtë projekt.

Mukades Gixhari. Zoti Mitat Daja lëri rradhë kolegut, të vazhdojmë rrjedhën e mbledhjes. Lëri rradhë kolegut cfarë bën kështu more burr i dheut?

Mukades Gixhari. Zoti Enver Memolla

Mitat Daja. Po jo ka llogjikë kjo punë.

Erind Tosku. Flasim me radhë Mitat .

Mukades Gixhari. Zoti Mitat të lutem pak respekt për kolegë.

Erind Tosku. Nuk po djeg vetëm ty bashkia more..

Mukades Gixhari. Zoti Enver Memolla

Mitat Daja. Mua nuk djeg fare.

Erind Tosku. Nuk të djeg?

Mitat Daja. Jo.

Erind Tosku. Bravo, na lër ne të flasim që na djeg. Na lër neve .

Mitat Daja. Se kam personal fare.

Mukades Gixhari. Zotin Enver Memolla, zoti Enver fjala për ju. Zoti Mitat të lutem ,mos ta përsërisim më herë tjetër. Debati kam të drejtë të gjithë këtu të diskutojnë, nuk kemi këtu vetëm zoti Mitat e dy të tjerë. Vazhdo zoti Enver Memolla.

Enver Memolla. Po kryetare faleminderit , realisht që mar fjalë në këtë debat parasyeje është fat keq se realisht të gjithë janë të informuar që nga ardhja e materialit të reformës territorial për arsye sepse në qarkun Tiranë nuk vendos të bëhet dëgjesë publike në qark dhe për këtë arsye të gjithë këshilltarët majtë djathtë jemi vënë në dijeni që do ndodhi kjo procedurë. Me mbylljen e dëgjesës publike dhe mbylljen e raportit kryetarit të bashkisë në këshillin bashkiak dhe sot të gjithë bëjmë të njëjtën gjë jemi kundra. Nuk është një çështje që po ndajmë ndihmë ekonomike por është një cështje që flitet për 42.000 banorë. Tani duhet t'i ndajmë disa gjëra dhe me veten tonë dhe drejtuesit dhe pjesën tjetër. Tani përsa i përket raportit të kryetarit të bashkisë e kam lexuar me vëmendje i kam thënë dhe dy tre gjëra dhe ku ishte dhe dëgjesa publike. Realisht ajo çka ta vret syrin është që ky raport i ardhur nga komisioni rreth tre fletë për shkrirjen e bashkisë Rrogozhinë

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

nuk korrespondon me të dhëna që ka sjellë në raport kryetar i bashkisë dhe raporti ka diçka për bazë ka marë shifrat por jo periudhat. Duhet krahasuar të dy raporte dhe për mua kur shoh raporti e kryetarit dhe këtë ka zero përputhje dhe të gjitha pikat që thotë raporti sidomos te këto pjesa që thotë banorët e Rrogozhinës marin shumë shërbime shëndetësore arsimore në Kavaj, zyrë arsimore kemi në Rrogozhinë nuk përmendet ky shërbim. Kjo është e paqartë në raport për cilën vit është marë.

Mukades Gixhari. Dëgjojmë pak zotin Enver.

Enver Memolla. Sepse këto të ardhurat në këtë volum pune në këtë bashki të madhe nuk besoj se është 83%. Dhe këtu në raport kjo cedon periudha, analiza e bërë për përciptasi te raportit duke parë që edhe për sa i përket numrit popullsisë të censusit është marrë parasysh vetëm censi i banorëve që jetojnë aty ,pa emigrantet dhe pyetja që lind kur bëhet ajo pjesa e menaxhimit apo pjesa e pastrimit i bëhet vetëm shtëpijave që jetojnë këtu sipas komisionit . E dyta për sa përket kilometrave që rruga që thotë 22 minuta kjo ka një kosto sepse unë që jam banorë i Rrogozhinës për të marë një shërbim nga bashkia e Rrogozhinës duhet të vijë këmbë kurse në Kavajë ka kosto kohore monetare dhe gjëra të tjera Nuk e kuptoj në cilin vit është marrë për bazë ky raport që ka sjellë komisioni i reformës territorial . Unë e kam shprehur vullnetin tim që jam kundër shkrirjes së bashkisë për të gjitha këto arsye. Por nuk ka një periudhë të përcaktuar se kur është marrë kjo analizë që ka bërë komisioni i reformës territoriale.

Mitat Daja. Kjo është vetëm një tekë e e një personi në komisionin e reformë .

Mukades Gixhari. Faleminderit zoti Enver.

Mitat Daja . Prandaj duhet kundërshtuar se është tekë, nuk ka asnjë lloj argumenti që Rrogozhina të shkrihet si bashki. Është tekë e një personi në reformën territoriale do ta bëjë. E ka zënë inati prandaj dhe unë kërkoj që ne të marrim hapa konkret jo thjesht formalizëm

Mukades Gixhari. Fjalën e ka Erind Tosku.

Erind Tosku. Ajo që na prek të gjithëve për shkak të replikave tregon këtë paqartësinë që ka sjellë drafti nga Ministria për ndarjen Territoriale. Dy letra janë që na ka sjellë drafti për bashkinë Rrogozhinë. Një sekondë me Silvana, më lër ta mbaroj të lutem. Janë dy letra dhe po t'i shohim pikat janë nga tre rrjeshta minimumi tre rrjeshta. Domethënë thuaj se bashkia Rrogozhinë nuk paska ekzistuar fare. Po lexonte kryetari draft raportin e bashkisë tonë u mërzitëm të gjithë ne. Aq shumë fjalë ka draft raporti kundër shkrirjes së bashkisë Rrogozhinë saqë ne u mërzitëm. Kjo tregon që ne kemi histori, tregon që ne bashkia jonë ka investuar për qytetin tonë. Ka historinë, ka kontributet e gjithë gjërat e tjera. Këtu nuk jemi për të parë gabimet e njërit për gabime tjetrit, edhe ne qytetarët kemi gabimet tona në vendimmarrje. Kemi bërë mirë, kemi bërë keq. Por kjo nuk do të thotë që për këtë ditë që jemi mbledhur sot të drejtën ne jemi për qytetin e Rrogozhinës, jemi kundra këtij projekt vendimi. Unë jam kundra këtij projekt vendimi nëqoftëse duhet marë

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

ndonjë masë më ekstreme, unë jam prapë pro për të marrë këtë lloj rrugë për bashkinë Rrogozhinë që të mbetet bashki. Kështu që po patët gjëra të tjera, për mendimin tim nuk është momenti. Ne jemi për qytetin e Rrogozhinës të rri bashkia ..O Silvana më fal nuk e kam replikë. Jo unë do jap mendimin tim nuk e kam as pyetje as përgjigje. Unë do jap mendimin tim si këshilltar, si qytetar që kam vendosur të rrijë këtu mos të emigroj , të rris fëmijën tim këtu të kontribuoj këtu. Duhet të jetë bashki. Unë për këtë qëndrim mbaj, kaq kisha.

Silvana Aliu. Ore këtë qëndrim e kemi dhe ne. Tani nuk kam të drejtën e pyetjes të dytë pse bashkia Rrogozhinë arriti në këtë pikë që ne të bashkohemi? Kemi të gjithë të drejtë ta dimë, historinë e dimë shumë mirë e dimë të gjithë po pse përfunduam aty?

Shpati Kolgega. Kryetare?

Mukades Gixhari. Shpati Kolgega.

Indrit Dedej . Jo, kam kënaqësi të flisni dhe ju si mazhorancë ne në mendim jemi të përbashkët. Po. Po disa gjëra duhet fol më shkoqur.

Shpati Kolgega. Besoj që në gjithë jemi një mendje vetëm duhet ta përmbledhim në shumë aspekte edhe pse po ndodh. Ka disa arsye që kjo po ndodh nuk është rastësore. Si fillim doja të thoja që konsultimet publike që janë bërë do të kishin patjetër një përfaqësues që t'i shpjegonte njerëzve reformë. Domethënë unë i kam parë konsultimet, po kush i ka shpjeguar njerëzve reformën pra si do bëhet? Si do jetë ndarja e re administrative, kuptimin e kompetencave, kuptimin e strukturës së bashkisë së re, kuptimin e mbledhjes së taksave, ndarjes së territorit, kompetencave që është thënë që mund të jenë nënkryetar. Pra nuk ka pasur një përfaqësues në komisioni i reformës territoriale t'i shpjegoj njerëzve që dhe ne sot besoj ju nuk jemi të qartë se si do bëhet fiks reforma, pra si do jetë bashkia e re në qoftë se do të bashkohet me Kavajë, nuk e dimë, do ketë një kryetar, do ketë dy nënkryetarë apo tre , njësitë do jenë siç janë, si do mbledhja e taksave, kush do të jetë struktura e re e bashkisë. Pra, nuk kemi asnjë lloj informacioni që besoj për s'i kemi ne jo qytetarët që nuk i kanë. Megjithatë besoj që kjo ka qenë një mangësi e reformës territoriale që do duhet të ishte kërkuar dhe nga ne dhe nga drejtuesit tanë me që të vijë ndonjë përfaqësues ta shpjegonte dhe nga ana teknike. Kjo nuk ka nuk ka ndodhur për fat të keq. Ndërkohë që nuk duhet të harrojmë ku ka qenë dhe Rrogozhina para 2015. Pra në sot kemi bashki që se kemi pas të jemi realist. Rrogozhina ka qenë nga Bishti i Zhurit deri tek lagja e Camëve poshtë kaq ka qenë. Nuk ka qenë as Kryevidhi, as Gosa, as Lekaj , as SinaBallaj. Kanë qenë të gjitha njësi dhe Rrogozhina ka qenë vetëm qytezë. Ne na dhuruan një bashki për fat të mirë që për fatin tonë të keq nga ana tjetër ne nuk e shfrytëzuam që ta ngrinim atë.

Mitat Daja. Ne nuk dinim të bënim pallate të mëdha sic bënë bashkitë e tjera.

Shpati Kolgega. Jo, nuk është çështje e pallate, është çështje që ne sot po flasim për shumë probleme nuk po flas vetëm për muaj që ka qenë kryetar i emëruar në detyrë, po flas përgjatë gjithë

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

këtyre viteve , nuk është përgjigj kërkesave të kohës kjo është dhe një nga arsyet që na ka sjellë këtu të jemi realist . Qarku Tiranë ka pesë bashki dhe ne jemi të vetmit që po shkrihemi ose që po kërkohet të shkrihet. Bashkia Vorë mos kujtoni se është më lart se ne është shumë jo funksionale sesa ne. Por ne po shkrihemi sepse jemi të pafuqishëm mendoj edhe nga ana e përfaqësimit politik nuk jemi deputetë nga Rrogozhina apo përfaqësues të zonës tonë që të jenë në parlament ,nuk kemi kryetarë bashkie për fat të keq atë që ndodh pra kryetar bashkie të zgjedhur me votë dhe kjo na ka dobësuar dhe përfaqësimin politik në qeveri parlament për të ngrijtur zërin. Këto janë prapë një pjesë e ndoshta më shumë e krahut tonë. Atë që ne po kërkojmë të bëjmë sot nuk e kemi pasur para 2015, të jemi të qartë. Na e kanë bërë dhuratë ne s'kemi ditur ta shfrytëzojmë , shpresoj që të vazhdojmë si bashki që të tregojmë që mund ta bëjmë këtë punë. Patjetër që qëndrimi është I njëjtë si të gjithë ju dhe qytetarët. Nuk mendoj se Kavaja funksionon më mirë sesa bashkia jonë. Ato kanë shumë probleme, territor shumë të madh, kanë shumë ndërtime. Bashkimi jonë do jetë një bashkimi i një lagje që s'do merret kush me ne pastaj. Kështu që me çdo përpjekje ligjore ta ngemë zërin tonë , vendimarja jonë sot nuk është politike, por është formale. Nuk është se ka ndonjë vlerë.

Mitat Daja. Normalisht duhet të kishte vlerë sepse ne jemi përfaqësues të gjithë komunitetit .

Shpati Kolgega. Nuk ka vlerë le të themi se në fund ka vlerë vota në parlament ,ne do ta çojmë mendimin e qytetarëve pastaj do shohim se çfarë vendimmarrje do meret.

Mukades Gixhari. Faleminderit zoti Shpati Kolgega.

Mukades Gixhari. Zoti Hekuran Xhani.

Hekuran Xhani. Të nderuar kolegë, kjo është vazhdim i një reforme territoriale që nisi që me reformën e vitit 2014 ku shërbimet në vend që t'ju afrohen qytetarëve rritën distancën, rritën kostat ekonomike dhe sot ne vijmë në këtë reformë në 2026 ku pushteti shkon drejt centralizimit. Pra qytetarët humbin të drejtën e vet për t'u vetëqeverisur për të marrë vendim për pushtetin që do të drejtojë. Kështu që ne si këshill e kemi shprehur vullnetin tonë që jemi kundër kësaj ndarje të re territoriale, por ky është një vullnet i mazhorancës qeverisëse dhe bashkia e Rrogozhinë për fat të mirë sot qeveriset po nga kjo mazhorancë që qeveris edhe Shqipërinë. Unë them le të përdoret nga mazhoranca e këshillit edhe negociatë nëpërmjet instrumentve sepse ne jemi përfaqësues politik në këtë këshill ,duke qenë mazhorancë i këshillit dhe bashkia udhëhiqet nga ju. Le të negociohet dhe me komisionin posaçëm të reformës, por edhe me instrumente të tjera nëpërmjet organizatës që keni ju, sepse po i shkaktohet një dëm i madh qytetarët. Unë këtu kam diskutuar gjithmonë mbështetje të administratës që administra t'i shërbente sa më mirë qytetarëve të vetë. Gjë që me të drejtë Shpati e përmendi, ne se arritëm t'ia afrojmë qytetarëve tonë. Ne sot kemi fermerë disponojnë toka e tapi shtëpie nuk kanë, taksat bashkia i mer. Faktikisht ato nuk janë pronarë të ligjshëm sot. Kjo është përgjegjësi e zyrës së kadastrës . Ne i premtuam për legalizim pa le çka u bë po shikoj dhe tani në hartë e reja që njerëzit po paguajnë për të marrë çertifikata e pronësisë një mbivendosje e papame në një pronë dalin tre pronarë. Pra është përgjegjësia e jonë si këshill

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

por dhe administratës të ngrihjet në nivelin e duhur. Unë e kam thënë pa një administratë të shëndoshë nuk do të kemi shërbime të mira për qytetarët. U bë reformë në 2014 s'harroj një deklaratë ish kryetarit të kuvendit do kursejmë 90 milion euro vetëm nga shkurtimi i administratës. Gjithsej ishim pesë njësi administrative kishim 170 punëtorë sot nga kryetari aktual i bashkisë dëgjoj që bashkia Rrogozhinë disponon 340 punëtorë. Pra administrata i larguam shërbimet qytetarëve me pretekstin se do të kursej duke shkurtuar administratën. Sot kemi dyfishuar administratën dhe kemi shkurtuar, larguar shërbimet qytetarë. Prandaj unë jam kundër kësaj reforme territoriale. Kjo është po ju theksoj edhe njëherë kjo bashki qeveriset sot nga Partia Socialiste është fat i mirë edhe për këto këshilltarë që janë kësaj force politike, por dhe për qytetarët. Le të negociohet në rrugë të tjera. Ai komisioni sikur na ka rënë nga qielli me të drejtë tha Shpatit të vijë një këtu teknik e të vijë sqaroj qytetarët pse largohet? Pse shkrihet kjo bashki? Pse shkrihet kjo bashki? S'kemi financa të gjithë kështu janë Kavajën dhe Vorën e morën petronazh qeveri atëherë për debi financiar. Kjo do të dëmtojë shërbimet qytetarëve do t'i humbi të drejtën për të vendosur qytetari, do ta paguajnë brezat që do të vijnë do shkojnë në Kavajë nga Sinaballaj do gjysëm dite punë për të zgjidhur një problem plus kostos . I kemi për fat të keq të gjithë pensionistët këtu edhe pensionet e fshatit janë 110 mijë lekë dhe me tre herë të shkuar në Kavajë iku pensioni. Unë i bëj thirrje mazhorancë, unë e bëj thirrje dhe opozitës që do mori pjesë sepse ky ligj do kalojë në parlament . Mos shkelni identitetin e qytetarëve shqiptarë një ditë do ta paguani keq për këtë keq qeverisje që po i bëni për ditë më shumë. Janë këto ligje, këto reforma që kanë shpopulluar sot Shqipërinë. E kam deklaruar dhe herë tjetër këtu. Luzi madh 4.000 banorë 2025 u mbyll me asnjë lindje. Ku po shkojmë? Të dashur këshilltarë, të dashur qytetarë, ku do shkojmë? Kush është ky që vendime atje , ore sovrani jemi ne sovrani është popull dhe ai duhet të vendosi për faktet e vet do të trajtoj ne sikur jemi dele e kopshtit të tyre. Edhe njëherë unë i bëj thirrje këshillit edhe qytetarët e bashkisë Rrogozhinës të gjithë në protestë të mbrojnë të drejtat tona s'kërkojmë asgjë më tepër sa na jep ligji dhe kushtetuta, ju faleminderit të gjithëve.

Mukades Gixhari. Faleminderit, zoti Hekuran.

Mukades Gixhari. Zoti Indrit thash ta kalonim në miratim.

Indrit Dedej. Po do e kalojmë zonja kryetare se ramë dakord të majtë të djathtë për hir të komunitetit se për hir të bashkisë performancën e thotë vetë qeveria e zotit nënkryetar në detyrë Andi Proshka. Nuk e thotë është opozita e thotë zoti Mazniku performancë jashtëzakonisht e dobët edhe mos them jo funksionale. Edhe për këtë kemi prova sa të duash po nuk është momenti edhe në momentin që ne e kemi marrë një vendim të përbashkët e thotë zoti Mazniku që bashkia Rrogozhinë performanca është zero, kurse unë dua të them që performanca e bashkisë nuk funksionon fare.

Mukades Gixhari. Atëherë faleminderit.

Indrit Dedej. Kështu që ne për hir të komunitetit, për hir të interesit të bashkisë, ne jemi kundra

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

bashkimit.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën katërt miratim i projekt vendimit për shprehjen e mosdakordësisë së Këshillit Bashkiak Rrogozhinë me propozimin për bashkimin e bashkisë Rrogozhinë me bashkinë Kavajë në kuadër të riorganizimit administrative territorial e hedhim në votim.

Pro,kundra, abstenim të gjithë pro miratohet.

Indrit Dedej. Është Saimiri, Sajmiri ka abstenuar.

Mukades Gixhari. Vërtetë?

Saimir Cani. Po

Mukades Gixhari. Atëherë një votë është absenim Sajmir Cani.

-Miratohet me 16- vota pro, 1-votë kundër, 0 abstenim projekt-vendimi "Për shprehjen e mosdakordësisë së Këshillit Bashkiak Rrogozhinë me propozimin për bashkimin e Bashkisë Rrogozhinë me Bashkinë Kavajë në kuadër të riorganizimit administrativo-territorial"

-(Në" Shkresën e Firmave" të Këshilltarëve bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, Këshilltari Saimir Cani nënshkruan shkresën dhe mbishkruan "kundër" për këtë arsye kjo votë konsiderohet kundër).

Vendimi nr. 32. Miratohet me 16 vota pro, 1 kundër projekt- vendim i propozuar nga Zv.kryetari i bashkisë me nr 3548. Prot 03.09.2026 "Për shprehjen e mosdakordësisë së Këshillit Bashkiak Rrogozhinë me propozimin për bashkimin e Bashkisë Rrogozhinë me Bashkinë Kavajë në kuadër të riorganizimit administrativo-territorial", si dhe relacioni i këtij projektvendimi me nr.3548/1.prot datë 03.09.2026 .

Indrit Dedej. Pas saj do të bashkohemi me ty Saimir.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën pesë miratimi i projektvendimit për dhënien e ndihmës së ekonomike për familjet në nevojë për muajin korrik 2026 nga fondi bllok i ndihmës 6%. Fjala për drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social zoti Ledion Hasani. Përshëndetje zoti Ledion.

Ledion Hasani. Përshëndetje, atëherë për muajin korrik 2026 janë 13 familje përfituese dhe fondi është 53.000 lekë .

Mukades Gixhari. Kjo është një pikë e mbartur nga mbledhja e kaluar, kemi materiale.Keni ndonjë pyetje për zotin Ledion e hedhim në votim. Pro ,kundra, abstenim? Pro të gjithë miratohet.

-Miratohet me 17- vota pro, 0 kundër, 0 abstenim projekt-vendimi "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2026 nga fondi Bllok-Ndihmës 6%.

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Vendimi nr. 33. Miratohet me 17 vota pro, projekt- vendim i propozuar nga Zv.kryetari i bashkisë me nr 3281. Prot 13.08.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2026 nga fondi Bllok-Ndihmës 6%", si dhe relacioni shpjegues i këtij projektvendimi me nr.3281/1.prot datë 13.08.2026 .

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën gjashtë miratimi i projekt-vendimit "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet e nevojë për muajin Gusht 2026 nga i pushtetit vendor" vazhdojmë po me zoti Ledion.

Ledion Hasani. Janë 23 familje përfituese dhe fondi është 97.000 lekë.

Mukades Gixhari. Edhe kjo është e mbartur e hedhim në votim pro kundra abstenim? Të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 17- vota pro, 0 kundër, 0 astenim projekt-vendimi "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2026 nga fondi i pushtetit vendor".

Vendimi nr. 34. Miratohet me 17 vota pro, projekt- vendim i propozuar nga Zv.kryetari i bashkisë me nr 3280. Prot 13.08.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2026 nga fondi i pushtetit vendor", si dhe relacioni shpjegues i këtij projektvendimi me nr.3280/1.prot datë 13.08.2026 .

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën gjashtë projekt vendimi i ndihmës ekonomike për familjet dhe nevojat shtator 2026 nga fondi i pushtetit vendor bashkia Rrogozhinë. Vazhdojmë po me drejtorin.

Ledion Hasani. Janë 22 familje përfituese dhe fondi është 99.000 lekë.

Indrit Dedej. Ngrihu o drejtor se je në rregull ne jemi tek ndryshmet ,ne duam pak përplasje tani.

Mukades Gixhari. Zonja Silvana.

Silvana Aliu. Ta kam thënë si tjetër po ta kërkoj mundohu të shtosh numrin sepse familjen që aplikojnë..

Ledion Hasani. Nuk na lejon ligji, nuk mund të dalim dot jashtë VKM kjo është formula .

Indrit Dedej. Po ndryshoj një çikë kësaj radhe se i rregullon.

Mukades Gixhari. E hedhim dhe votim . Pro, kundra ,abstenim të gjithë pro miratohet.

Miratohet me 17 vota pro, 0 kundër, 0 astenim projekt-vendimi "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2026 nga fondi i pushtetit vendor.

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Vendimi nr. 35. Miratohet me 17 vota pro, projekt- vendim i propozuar nga Zv.kryetari i bashkisë me nr 3544. Prot 03.09.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2026 nga fondi i pushtetit vendor",si dhe relacioni shpjegues i këtij projektvendimi me nr.3544/1.prot datë 03.09.2026 .

Mukades Gixhari. Tek të ndryshmet kush ka dicka me diskutuar.

Mitat Daja. Duroni një minutë .

Silvana Aliu. Mbledhjen tjetër ikim ne…

Mitat Daja. Meqë është nën prefekte këtu e kam prandaj kam diçka tjetër për për kryetarin në detyrë të bashkisë. Po fillon shkolla a ka bërë bashkia ndërmend për nxënës që janë nuk kanë mundësi për çanta për mjete shkollore ose bashkia vetë ose t'i bëjë thirrje bizneseve, të organizohet diçka ose ne si këshill bashkiak të organizojmë diçka për fillimin e shkollës, për nxënësit në nevojë, për çanta, për mjete shkollore. Unë nga vetja ime nuk po e them për mburrje, shpresoj që mos quhet mburrje nga biznesi im do përgatis 10 çanta me mjete shkollore për nxënësit në nevojë. Shpresoj që këshilli bashkiak ta marri këtë nismë bashkë dhe bashkia gjej mundësitë e veta, kapacitetet që ka të ndihmojnë sepse ka shumë nxënës që nuk kanë mundësi ta blejnë çantën e re dhe t'i blejnë mjetet shkollore. Unë ky këtë e kam sugjerim, nuk e di kush zyrë e mer përsipër këtë punë. I drejtohem kryetarit në detyrë edhe ai e din si delegon punën e tij.

Andi Proshka. Ok.

Mitat Daja. Shpresoj që të dëgjohet kjo fjalë dhe të zbatohet. Kaq këto kisha kurse të vij nënprefekja na sqaro atë problemin.

Hekuran Xhani. Unë kam një pyetje për kryetarin e bashkisë në 5 shtator po fleti dhë një lajm nuk e di sa i vërtetë është që në Vilë Bashtovë në tokë ranore 77 hektar i hiqen territorit që ka Ministria Turizmit dhe Sportit dhe i kalon për ndërtime pallatesh dhe resorte ministrisë së zonjës Anila Denaj, ush është kjo e financave, ekonomisë? Kjo bëhet fjalë për plus edhe ndryshime të tjera shkon 170 hektar, Bëhet fjalë te prona 284 /5 zona kadastrale 3774 sipas edhe njëherë…

Andi Proshka. Atëherë nuk kam asnjë informacion por ata janë prona të industrisë të turizmit.

Hekuran Xhani. Ata janë prona të qytetarëve shqiptarë, ata janë prona të bashkisë të qytetarëve, tani dëgjo, unë e kuptoj…

Andi Proshka. Është në territorin e bashkisë, por nga ana e bashkisë për ato nuk meret asnjë vendim, nuk kanë as shpjegime.

Indrit Dedej. Mos janë ndonjë bazë ufosh?

Andi Proshka. Si?

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Indrit Dedej. Si ka mundësi në territorin tënd të mos e marrësh vesh se e kujt është mos është ndonjë bazë ufosh.

Indrit Dedej. Tani kjo është sipërfaqe brenda teritorit duhet të jeni të informuar.

Mukades Gixhari. Zoti Indrit përgjigjen po ia jep zotit Hekuran.

Andi Proshka. Të lutem pak respekt.

Indrit Dedej. Kryetar , kryetar në detyrë në fakt se sje akoma kryetar.

Mukades Gixhari. Pak rëndësi e ka fjalën zoti Hekuran.

Indrit Dedej. Unë kur e shpreh …

Mukades Gixhari. Të lutem zoti Hekuran.

Indrit Dedej . Zonja kryetare ti e ke shkelë rregulloren me të katërta këmbët.

Mukades Gixhari. Po I mer fjalën kolegut, nuk lejohet nuk lejohetvazhdo vazhdo zoti Hekuran.

Hekuran Xhani. Ti zoti kryetar, unë e kuptoj që është pronë e Ministrisë së Turizmit dhe është pronë që ndodhet brenda territorit të bashkisë së Rrogozhinë edhe duke qenë brenda territorit të bashkisë Rrogozhinë do të ketë dhe një vendimmarrje edhe nga pushteti vendor bashkia Rrogozhinë. U gllabërua çdo gjë në këtë vend edhe tani paska ngel e fundit edhe Spilleja Vila pa u gllabëruar. Zyra urbanistikës herën tjetër të bëjë një verifikim dhe të na sjellin ne këtë sipërfaqe toke me hartë ku ndodhet, sa është dhe si është. Qytetarët e bashkisë Rrogozhinë i ka sjellë zoti në Rrogozhinë edhe ç pasuni që është këtu në Roguzhinë është e këtyre qytetarëve, duhet të vendosin këto qytetarë sepse cdo gjë e ndërtoi populli shqiptarë me punë vullnetarë hirocentralet. sot po i marin oligarkët e po shkelim djersën dhe gjakun e të parëve tanë .Unë kërkoj nga ana jote bashkë me administratën të më sjellësh një informacion të saktë për këtë sipërfaqe që të informojmë qytetarët në rast se qytetarët e meritojnë le ta marin.

Andi Proshka. Patjetër, nga sot që bëre kërkesën do shohim cfarë mund të bëjmë .

Hekuran Xhani. Edhe një hartë orientuese që ta dimë ku ndodhet.

Indrit Dedej. Zonja kryetare.

Mukades Gixhari. Po ,zoti Indrit.

Indrit Dedej. Nuk mund të më evitosh sepse ka shumë problematika ta dini këtë gjë.

Indrit Dedej. Sa për kolegun vetëm një gjë shtoj që pa pëlqimin e kryetarit të bashkisë nuk ka shans që të lëvizi qoftë edhe një leje për për çdo gjë. Kryetari i bashkisë është pronar i shtëpisë edhe çdo tjegull pa pëlqimin e tij nuk ka shans ta japin.

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

Andi Proshka. Unë përfaqësoj popullin nuk janë pronar.

Indrit Dedej. Po jo, në momentin që ulesh te karrigia e kryetarit të bashkisë ti je i pari i shtëpisë përfaqëson,a kupton? Edhe këtë ta kesh pa pëlqimin e bashkisë nuk po them pastaj ke institucionet si këshilli bashkiak që ka ato të vetat kur flitet për prona që je i detyruar ta kalosh në këshill bashkiak se s'mund ta japësh sipas qefit. Së dyti pastaj ka kërkesa nga qytetarët për problematikë që kanë ardhur me posta edhe këtu në Këshill Bashak nuk vijnë. Ne kemi një zyrë juridike dhe konflikteve edhe nuk e di pse s'vijnë se janë drejtuar dhe këshillit bashkiak edhe bashkisë.

Andi Proshka. Na përcill rastet..

Indrit Dedej. Po rastet ti përcjell se i kam në telefon do të përcjell edhe postën se çfarë ditë ka ardhur. Ja unë po ta përcjell si problematikë ke problematikën kafe rinia lart për një banesë që është e pabanueshme dhe e kanë mëshirë të fatit edhe i prish punë të gjithë banorëve. Tani mua më jep shpjegim pastaj mbrapa si ka mundësi një qytetar që mund të jetë i çmendur në rast ka ndodhur ,mund të jetë jashtë shtetit çdo gjë mund të mos jetë ky fare ,mund të jetë pronë pronë që s'ka njeri trashëgimtar. Edhe si ka mundësi që ky lloj konflikti kaq kohë të gjatë edhe ju s'e zgjidhni. Është rasti kafe rinia lartë tek Kol Bakallit.

Mitat Daja. Po në katin e pestë.

Indrit Dedej. Se di unë çfarë kati, edhe fasadën që ka bërë bashkia që ka paguajtur taksat, ky rindërtimit që është hap fasada është hap është hap si si mos më keq. Detyra e kujt është kjo ? Jo, ti e ke të dërguar sepse ka ardhur me post sekretarja duhet të informojë. Në qoftë se s'të informohet do të thotë që nuk funksionon.

Mitat Daja. Faktikisht ky rast se po ndërpres Indrit është dërguar disa herë..

Indrit Dedej. O shoku këta po vriten,kanë shkuar në polici e po vriten. Si ka mundësi që këshilli bashkiak ka një komision konfliktesh ku gjejë të drejtën qytetari shqiptar .

Andi Proshka. Presim që të restaurohen gjithë.

Indrit Dedej. Po e ka bërë pra njëherë e ka bërë rindërtimi o kryetar. Këtu mban përgjegjësi edhe

firma që kanë bërë punimet se nuk ka më shumë se dy vjet që është bërë , është turp.

Andi Proshka. Edhe ju dini shumë mirë që ne e kemi sjellë bashkinë dhe kemi bërë dhe disa investime.

Indrit Dedej. Unë këtë e kam me foto të postës, njerëzit kanë shkuar në polic dhe policia thotë ka bashki edhe realisht ka bashki , bashkia është rregullator në këto raste.

Andi Proshka. Mos I mohojmë punët që janë bërë.

Indrit Dedej. Unë se di çfarë pune ke bë ti njëherë më trego çfarë pune ke bë ti që po bën tetë

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

muaj kryetar në detyrë. Më jepi çik çfarë punë ke bërë…. Tjetra ku e kisha, rindërtimi o kryetar më vjen keq o Mitat Daja njëherë që more detyrë si kryetar i komisionit se përfundove duhet të përfundosh mbledhjen e radhës mbylljen e komisionit.

Mitat Daja . Bashkë me nënkryetarin,

Indrit Dedej. Sepse rindërtimi është skandal është për gjynah i kanë lënë fëmijët në rrugë edhe dua ti si kryetar ç'të kanë pruar ç'të kanë bërë, mbylle se na fulliqe kështu.

Mitat Daja. Me nënkryetarin po them do ta bisedoj me komisionin.

Indrit Dedej. Qytetarët presin, nuk presin nga unë kam shumë gjëra . Po ia lë fjalën Silvanës.

Mukades Gixhari. Po zonja Silvana.

Silvana Aliu. Bëmë një tender për zjarrfikëse sepse ishte urgjente, dua informacion ku jemi me zjarrëfikësen.

Andi Proshka. Bëj një shkresë e të japim përgjigje, është në proces e sipër.

Silvana Aliu. Ju thatë e kemi urgjente, po iku vera kur do e blini?

Enkela Ballabani. Tani është në procedurë ka afate ligjore ka dhe procedura ligjore që respektohen afatet.

Andi Proshka. E more përgjigjen?

Silvana Aliu. Po pra .E dyta po flas për përballë parkut, ajo pjesa e para lulishtes e kam ngrejt disa herë këtë punën e lulishtes. Çdo dyqan bën rrugën e tij , domethënë e prish lulishten bën direkt dalje. Ajo ka qenë një nga lulishtet më të bukura, a ka mundësi të kthehet në gjendjen e mëparshme siç e kemi këtu përballë bashkisë që e kemi është shumë e bukur. A ka mundësi të kthehet?

Andi Proshka. Po ta verifikojmë .

Silvana Aliu. Po dhe për pastrimi që ngel aty është Vali për pastrimin e qytetit, të paktë kur ka ndeshjet e sportit që janë këto ndeshjet me të huaj merru një çikë pastrimin.

Andi Proshka. Pastrimi bëhet çdo ditë sigurisht, që ne gusht ka problematika sepse shtohet numri i popullsisë.

Silvana Aliu. Drejtori i arsimit është këtu? Shif se ke disa klasa që kanë nevojë për lyerje.

Indrit Dedej. Por edhe taksën që i kërkojnë familjarëve, ç është kjo taksë..

Silvana Aliu. Nga informacionet që na kanë ardhur ne kemi vënë një taksë për kopshtet dhe prindërve po i merret 30 mijë lekë, verifikoje dhe në qoftë se ashtu hiqet taksën fare.

Indrit Dedej. Zonja kryetare pyetje e fundit që e kam meqë kemi në dëgjesë dhe nënprefekten.

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Indrit Dedej. Ne duam një përfaqësues të prefekturës këtu që të na tregojë vlefshmërinë e nënkryetarit në detyrë të bashkisë sepse është i paligjshëm. Kryetari i bashkisë nuk ka kaluar nga këshilli bashkiak. Kryetari i bashkisë nuk mund të punojë, nënkryetari në detyrë është për 45 ditë nuk është për gjashtë muaj për 30 muaj edhe kërkojmë nga prefektura që të na sjellim në ligjëshmëri ose në të kundër do të shkojm gjykatë administrative edhe do hedhin po prefekturën do ta çojmë te SPAK për shpërdorim detyre. Nuk mund të rrijë një kryetar bashkie me një copë letër nga prefektura pa kaluar në këshill bashkiak .Ne këtu punojmë vetëm nga kryetarë të votuar nga populli dhe jo nga kryetarë të vendosur nga rruga.

Mukades Gixhari. Zoti Enver Memolla fjala për ju.

Andi Proshka. Këtë e përcakton ligji.

Indrit Dedej. Po na sill pak ligjin.

Andi Proshka. Po pra ki pak respekt, nuk kam ardhur nga rrugë unë. Po pra kam qenë pjesë e institucionit të bashkisë, kam qenë nënkryetarë i vetëm dhe jam sot.

Indrit Dedej. Je nënkryetar, jo kryetar bashkie.

Andi Proshka. Smë thua dot ti mua ke ardhur nga rruga.

Indrit Dedej.Jo unë ja kërkoj prefekturës.

Andi Proshka. Po pra po jam unë sot këtu. Po ti ke shpërdoruar detyrën..

Indrit Dedej. Unë nuk po ta them ty, po ia them kryetares së këshillit se atë njoh, nuk të njoh ty sepse nuk ke kaluar nga këshilli bashkiak ,edhe ato nletra nga prefektura që ke kaluar nga këshilli bashkiak nuk pinë ujë, ja ky është këshilli.

Mukades Gixhari. Zoti Indrit t'ja japim fjalën zotit Enver Memolla . Zoti Enver fjala për ju.

Indrit Dedej. Se dhe ti kryetare kështu je…

Mukades Gixhari. Po shyqyr që të kemi ty more, ne shyqyr që të kemi ty që je i miri mes.. Zoti **Enver Memolla.** Dy pyetje kam për kryetarin. Një është për me urën që është shembur e që lidhet fshatrat e Rrogozhinës që faktikisht është në territorin e Peqinit. Çfarë po ndodh se po afrohen dhe shirat?

Andi Proshka. Ajo ura është në territorin e bashkisë Kavajë më fal të Peqinit. Jemi duke u marë me të bashkë me bashkinë e Peqinit.

Mukades Gixhari. Pak respekt për kolegët.

Enver Memolla. Pyetja e dytë është për fondin e miratuar në këshill bashkiak për rrugën e Malësisë që lidhet me Sinaballaj.

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

Andi Proshka. Është proces.

Mukades Gixhari. Zoti Shpati Kolgega.

Shpati Kolgega. Një gjëshumë e rëndësishe që harrova ta nënvizoj për sa i përket çështjes së reformës territoriale.

Mukades Gixhari. O zonja Silvana po të dëgjojmë zotin Shpati Kolgega.

Shpati Kolgega. Pjesë e reformës territoriale që harrova pak më parë duke qënë se ne përfaqësojmë siç e thatë dhe ju shumicën dhe qeveri në këshill herë pas here jo jo gjithmonë që ne kemi kërkuar dhe besoj që do realizohet një një takim për të dhënë argumentat tona për sa i përket reformës . Ne e kemi kërkuar si forcë politike si përfaqësues të partisë socialiste ne kemi kërkuar një takim është premtuar që do kemi një takim të tillë përpara se kjo do kaloj në parlament, do të kemi mundësinë të japim argumentet tona.

Mukades Gixhari. Silvana të lutem pak respekt për Shpati Kolgegën se ju dëgjoi të gjithëve me rradhë.

Indrit Dedej. Atë atë duam të rrijë bashkia, debatet do ti bëjmë se për atë punë jemi këtu, jemi opozitë.

Shpati Kolgega. Kemi detyrim ndaj qytetarëve për të dërguar argumentat tona pastaj dhe kjo do jetë para se të merret vendimi.

Mitat Daja. Po pse se thatë që në fillim ju, të mos ishim zënë kot.

Mukades Gixhari. Zonja Alime se kemi dëgjuar.

Alime Hoxha. Dy pyetje kam dhe unë.

Mukades Gixhari. Më fal, më fal zonja Silvana mund ta zgjidhësh me drejtoreshën diku, pa prishur..

Indrit Dedej. Po ka një dëshirë do e rregulloj po s'ka dëshirë ..

Alime Hoxha. Tani pastrimi i qytetit ka probleme edhe për muajin gusht ka patur, kanë ndenjur edhe dy ditë koshat kështu. Për pastrimin keni shumë punë për të bërë besoj duhet t'i merrni masat se është pjesa më e parë që bien në sy. Kisha një diskutim për cerdhet të cilat funksionojnë deri në orën 15:00. Ne e dimë që administrata është në punë deri në orën 16:00 ose punonjësit që punojnë nëpër fabrika punojnë deri në orën 16:00. Ata që i sjellin fëmijët aty, mirë që një kopësht me drekë nuk e kemi por cerdhja të funksionojë deri në 16:00 si institucionet e tjera.

Shpati Kolgega. Në Tiranë janë deri në 17:00.

Alime Hoxha. Le të bëjnë një marrëveshje dhe ato punonjësit mos vijnë të gjitha në shtatë por të

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

vijnë dy në shtatë dhe të rrinë dy deri në katër të kordinohet puna.Ti marësh fëmijët deri në 14 :45 ku të gjithë janë në punë, se di ta shikojmë pak këtë pjesë. Kopshtin me drekë ne nuk e bëjmë dot..

Shpati Kolgega. Po pse nuk e bëjmë dot me drekë?

Andi Proshka. Ka problem me hapësirat.

Mitat Daja. Ska ambient.

Hekuran Xhani. Të paktën për qytetin ka mundësi të bëhet, besoj se për qytetin arrihet është e mundshme.

Andi Proshka. Problemi është i gjithi tek hapësira, nuk kemi një hapësirë të madhe që të bëjmë të gjitha kushtet.

Hekuran Xhani. Investim jo, po duhen njerëz, duhen burime njerëzore. Ne kemi popull në Shkozet, tre psh janë atje dhe do të bëret kuzhina për tre sipas numrit. E ka, e kupton për qytetin? Unë them që është e mundshme kjo që të arrihet t'i bëhet drejt qytetit.

Shpati Kolgega. Është një model që bëhet diku për Tiranë e të tjera, të merret modelin dhe të jemi në diskutim..

Mukades Gixhari. Pyetje tjetër? Meqë nuk kemi më pyetje për të diskutuar mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur, ju faleminderit!

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 40^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 1 orë :33 min : 11sek.
- Ky procesverbal i mbyllet në faqen (31).

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera

Kryetare e Këshillit
Mukades Gixhari

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com